



NGJALLJA

Nr. 10 (177) Viti XVI i botimit

TETOR 2007

Çmimi 20 lekë

Një tjetër mundësi edukimi për të rinjtë Hapet Shkolla e re e Mesme Kishtare “Kryqi i Nderuar”, në Sukth, Durrës



Godina e re e shkollës në Sukth të Durrësit, dhe një kujtim nga dita e parë e mësimit.

Shkollat e hapura nga Kisha:

1. Akademia Teologjike “Ngjallja e Krishtit”, Shën Vlash, Durrës.
2. Instituti i Formimit Profesional “Frymë Dashurie”, në Tiranë dhe dega e tij në Gjirokastrë.
3. Liceu Kishtar “Kryqi i Nderuar”, Gjirokastrë.
4. Shkolla 9-vjeçare “Protagonistët”, Tiranë.
5. Shkolla 9-vjeçare “Frymë Dashurie”, Durrës.
6. Shkolla e Mesme Kishtare “Kryqi i Nderuar”, Sukth, Durrës.
7. Shkolla e mesme profesionale në Mesopotam, Sarandë.
8. 15 kopshte në arsimin parashkollor.


Si rrjedhojë e nivelit jo të mirë të shumë shkollave, edukimi i fëmijëve është kthyer në një nga shqetësimet kryesore të prindërve. Një shqetësim tjetër janë edhe mjediset jo të përshtatshme ku zhvillohet mësimi, sidomos në shkollat 9-vjeçare edhe të mesme nëpër rrethe. Duke parë këtë situatë, në vazhdim të investimeve të rëndësishme që ka bërë në vazhdimësi për edukimin, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë ndërmoi një nismë të re: Hapjen e Shkollës së Mesme Kishtare Jopublike “Kryqi i Nderuar”, në Sukth të Durrësit. Kjo u bë e mundur me fondet që siguroi Kryepiskopi Anastas nga donatorë të huaj, miq dashamirës të Kishës sonë, si për blerjen e godinës të bollshme dhe piktorese, ashtu edhe mbarëvajtjen dhe pajisjen e saj.

Sipas drejtorit, z. Anastas Dod-biba, “shkolla ofron vlera të mëdha
(Vijon në faqen 2)

Kryepiskopi Anastas i dhuron të dënuarve një fushë sportive

- *Mbahet premtimi
i dhënë gjatë një vizite
të mëparshme -*

Gjatë vizitës në periudhën e Krishtlindjeve në Institutin e Edukimit të të Dënuarve Penalë “Ali Demi”, i njohur edhe si burgu 325, Kryepiskopi Anastas, pasi vizitoi mjediset e ndryshme, shprehu dëshirën për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetës së të dënuarve. Nga drejtuesit e Insti-



Hirësi Andoni dhe drejtori Shehri duke prerë shiritin e përrurimit

tutit iu kërkua, nëse do të ishte e mundur, që të financonte për ndërtimin e një fushe sportive, për rreth 160 burra që vuajnë aty dënimin, kryesisht të moshave të reja.

Kryepiskopi e pranoi me kënaqësi këtë kërkesë dhe siguroi fondet e nevojshme. Shpejt, në një mjedis tërë gurë dhe që përmytej

nga uji kur binte shi, u ngrit një fushë bashkëkohore minifutbolli dhe për lojërat me dorë, me tapet të gjelbër artificial, e rrethuar me rrjetë dhe me sistem ndriçimi, e cila mund të shërbejë edhe për sporte e veprimtari të tjera. Kostoja e saj shkoi rreth 20 mijë USD.

(Vijon në faqen 6)

Një tjetër mundësi edukimi për të rinjtë Hapet Shkolla e re e Mesme Kishtare “Kryqi i Nderuar”, në Sukth, Durrës

Çast
nga
një orë
mësimi
në shkollën
e re
“Kryqi
i Nderuar”,
në Sukth,
Durrës.



(Vijon nga faja 1)

shpirtërore, duke i harmonizuar ato me informacionin shkencor dhe mësim-edukativ që këta të rinj do të marrin.” Shkolla ndodhet në një pozicion shumë të bukur edhe është një nga më modernet në Shqipëri.

Programi është i njëjtë si në shkollat e tjera të mesme të përgjithshme, me të njëjtin informacion shkencor. Krahas tij do të ketë edhe lëndë teologjike, si p.sh. etikë e krishterë, katekizëm, muzikë kishtare, ikonografi etj. E veçanta e kësaj shkolle është se do të punojë mjaft edhe për krijimin e një personaliteti të shëndoshë të nxënësve dhe gjithashtu do t'i ndihmojë në formimin dhe rritjen e tyre shpirtërore.

Shkolla është e pajisur edhe me konvikt, ku kushtet ashtu si në gjithë mjediset e saj, janë nga më bashkëkohoret.

Për të përzgjedhur nxënës me nivel të lartë, u organizuan konkurse nëpër dioqeza, ku nxënësit iu nënshtruan testimi në matematikë dhe në gjuhë shqi-

pe. Më pas u zhvillua një intervistë me secilin, për të kuptuar më shumë rreth karakterit dhe formimit. Rekomandimet e mësuesve të mëparshëm, si edhe të klerikëve, ishin një kriter mjaft i rëndësishëm në përzgjedhjen e kandidatëve. Pas këtyre vlerësimeve fituan 37 nxënës, 22 prej të cilëve hynë në vitin e parë, edhe 15 në vitin e dytë.

Të gjithë nxënësit do të vazhdojnë shkollën me bursë të dhënë nga Kryepiskopi Anastas.

Enea Andoni, një nga nxënësit e vitit të parë, tha se: “Mundësia që më jepet për të vazhduar këtë shkollë është mjaft e çmuar për mua, pasi besoj se kjo do të më ndihmojë të shtoj dijet e mia, por gjithashtu do të më ndihmojë edhe në jetën time shpirtërore”.

Shkolla “Kryqi i Nderuar” në Sukth, hapet pas një përvoja të gjatë e të bukur dhe shumë pozitive të shkollës së parë të mesme kishtare “Kryqi i Nderuar”, në Gjirokastrë, të hapur që në shtator të vitit 1998. Stafi

mësimor e administrativ i kësaj shkolle është mjaft i përgatitur dhe janë mjaft të përgjegjshëm ndaj detyrës së tyre kryesore, në formimin shkencor dhe shpirtëror të të rinjve.

“Për mua, është një ngjarje e veçantë e jetës sime që jam përzgjedhur të punoj në këtë shkollë, një shkollë që besoj se do të funksionojë për të përgatitur breza të cilët do t'i shërbejnë shoqërisë dhe Kishës sonë Orthodhokse”, - tha z. Koço Josifi, mësues matematike.

Ashtu siç u shpreh edhe drejtori, kjo shkollë është një gur tjetër i çmuar që do t'i shtohet gjerdanit të artë të veprave të Fortlumturisë së Tij, Kryepiskopit Anastas, që në historinë e vendit tonë do të shkëlqejë edhe ndriçojë brezat e ardhshëm të rinisë.

Tashmë me këtë shkollë të re në Sukth të Durrësit Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë ka dy shkolla të mesme kishtare.

Marina Marini

Ky reagim, si të tjerë, iu dërgua gazetës “Shekulli”, që nuk e botoi, pasi preferon shkrimet ku sulmohet dhe jo mbrohet Kisha

Kur të akuzojnë për pronën tënde...

E lexova shkrimin me interes, jo për përmbajtjen, por sepse përbënte një rekord jo vetëm tendencioziteti, por edhe mungese elementare të etikës profesionale. Nëse merr përsipër të shkruash për diçka që s'e ke idenë, së paku duhet të marrësh mundimin të pyesësh ...

Së pari, shkruesi Nergjoni nuk di as se për kë po flet. Ai fut në valle “komunitetin katolik të Elbasanit”, duke krijuar një ngatërresë qesharake dhe vetëdemaskuese. I mësojmë se objektet në fjalë janë të Komunitetit Orthodhoks, i cili në Elbasan ka 6 priftërinj kanonikë, të ligjshëm, të cilët varen nga e vetmja Kishë Orthodhokse që vepron në Shqipëri, që kryesohet nga Sinodi i Shenjtë me 6 episkopë; siç përcakton Tomosi i Autoqefalisë dhe siç e njohin si autoritetet shqiptare ashtu dhe çdo kishë e krishterë (jo vetëm orthodhoksët) e botës mbarë.

Së dyti, padija nuk është arsye që të thotë se “Normalja” është “300-vjeçare”. Kjo shkollë e shquar e arsimit kombëtar do të mbushë së afërmi 100 vjet, pasi u hap në vitin 1909. Ndërsa godina në fjalë, u ndërtua nga Kisha Orthodhokse me kontributin e besimtarëve në vitin 1736 dhe i shërbeu nevojave të saj. Ishte Kisha Orthodhokse që ia vuri në dispozicion, pa pagesë, Normales dhe jo e kundërta. Në vitin 1991 ajo nuk shërbente më si shkollë, por si një muze lokal, i cili u shkatërrua si përmbajtje dhe si godinë. Më pas Kisha, e cila e kishte rimarrë pa asnjë protestë, nga askush, pronën e saj, investoi rreth 150 mijë dollarë (me vlerën e atëhershme), për ta rikonstruktuar nga themelet dhe për të ngritur një qendër shërbimesh sociale për qytetin. Por erdhi viti i mbrapshtë 1997 dhe qytetari privat N. Marku e uzurpoi me forcë dhe... e dha me qira, para të cilat i futi në xhepin e tij privat. Kjo është dhe arsyeja bazë e interesit të tij “patriotik”.

Së treti, në fjalët që thuhet nga shkruesi dhe në citimet flitet me mllef ndaj murgjve ose godinave kishtare. Si është e mundur që fjalë të tilla të dalin nga goja e njerëzve që pretendojnë se janë orthodhoksë. Si është e mundur që njerëz të tillë të preferojnë çdo gjë para interesit të komunitetit të cilit pretendojnë se i përkasin. Peshkopët dhe murgjit janë baza mbi të cilën ngrihet hierarkia dhe e ardhmja e një Kishë Orthodhokse, pa ta nuk ka kishë. Shprehje të tilla i përshtaten vetëm anëtarëve të njëhershëm të Partisë së Punës apo ekstremistëve anti-të-krishterë.

Por, ç'mund të presësh nga një njeri që vesh në mënyrë abuzive rrobën e priftit dhe mashtron të paditurit me shërbesa qesharake; ata nuk e dinë se martesat, pagëzimet apo përshtirjet e tij janë po aq të pavlera për gjithë Kishën Orthodhokse, sa po t'i bënte vetë zoti Nergjoni.

Sa për marrëveshjet me komunitetet fetare që pritet të miratohen, ato (të paktën teorikisht), ndër të tjera do t'i presin rrugën pikërisht mashtruesve të tillë.

D.T.

Kisha Orthodhokse e Shqipërisë në vitet e diktaturës komuniste

- 3. Duke imituar Revolucionin Kulturor Kinez: Shpërthimi i terrorit ateist -

Pas prishjes me BS dhe forcimin e marrëdhënieve me Kinën, pozita e Enver Hoxhës brenda vendit ishte forcuar mjaft. Pavarësisht se propaganda shtetërore e interpretonte si meritë të udhëheqësit të saj, dihet se ky fakt i kushtohet indiferentizmit që treguan shtetet e Lindjes për zhvillimet politike në Shqipëri, por edhe apatisë që shfaqti Perëndimi në çastet më vendimtare për të ardhmen e qytetarëve të saj. Në mesin e viteve '60 diktatori shqiptar, «i përkëdhelur» nga koniukturat ndërkombëtare, por edhe i mikluar nga «shokët kinezë», të cilët e kishin quajtur Shqipërinë «far ndriçues të Evropës», bënte ç'ishte e mundur të lançohej në gjirin e lëvizjes komuniste të Botës së Tretë si një partner i denjë ideologjik i Mao Ce Dunit.

Në gusht 1966 në Kinë shpërtheu Revolucioni Kulturor. Gardistët e kuq morën urdhër të luftonin kundër «traditave dhe zakoneve prapanike» dhe përfaqësuesve të tyre. Viktimat e këtij Revolucioni ishin kryesisht personalitete të artit e të kulturës, veprat e të cilëve u censuruan pasi u akuzuan se po çonin vendin në regres. Në Shqipëri jehona e Revolucioni Kulturor Kinez u bë akoma më e ndjeshme ditët e para të 1967-ës. Gazeta «Zëri i Popullit», më e madhja në vend, organ i PPSH, i kushtonte mjaft hapësirë shkrimeve të botuara në gazetë kineze «Zheminzhibao» dhe «Hunci», të cilat paralajmëronin me tone ofensive se viti 1967 do të

jetë viti i fitores përfundimtare mbi ideologjinë borgjeze dhe klasat shfrytëzuese, në të gjithë sektorët e infrastrukturës që nuk pajtohen me bazën ekonomike të socializmit.

Në të njëjtën periudhë u vu re një ashpërsim akoma më i madh i kontradiktave midis Kinës dhe BRSS. Vizita e kreut të Sovjetit Suprem Podgorni në Selinë e Shenjtë nxehi gjakrat. Mao Ce Duni akuzoi Papa Pavlin IV se po komplotonte me BS në dëm të vendit të tij. Të njëjtat akuza drejtoi edhe ndaj patrikut ekumenik



Athinagora dhe kreut të Kishës Anglikane Ramsey, takimet e të cilëve me papën e Romës u stigmatizuan «jo si takime për çështje shpirtërore, por për qëllime politike, që synojnë të intensifikojnë luftën e tyre kundër popujve, kundër revolucionit». Kinezët i hidhnin benzinë zjarrit kur deklararin se kërret e krishterë po universalizonin krishterimin për t'ia kundërvënë atë ideologjisë komuniste.

Në një kohë, pra, që feja tregohej me gisht nga «shokët kinezë» si shkaktarja kryesore e shtypjes dhe e shfrytëzimit të proletarietit ndërkombëtar, Enver Hoxha shfrytëzoi rastin t'u tregonte me vepra se Revolucioni Kulturor Shqiptar ishte po aq i denjë sa edhe ai i tyre, madje i pasuruar me elementë që përbënin risi në rang botëror. Në Kongresin V të Partisë që u mbajt në nëntor 1966, ky ithtar i flaktë i «luftës së klasave» deklaroi se «edhe lufta kundër ideologjisë fetare është luftë klasash». Dy muaj më vonë, më 6 shkurt 1967 ai mbajti përpara organizatave-bazë të PPSH në Tiranë fjalimin e tij të njohur me temë «Revolucionarizimi i mëtejshëm i Partisë dhe i Pushtetit». Kuptohej qartë se toni i ashpër që përdori në këtë fjalim ndaj komunistëve që tregoheshin liberalë ndaj zbatimit të direktivave që vinin nga lart, kërcënimi se brenda dy muajve do të jepnin llogari secili prej tyre personalisht dhe jo si

(vijon në faqen 4)

Shtypi shqiptar vuan dukshëm nga anësia në trajtimin e çështjeve. Kjo e pashkëputur nga niveli i ulët profesional, që e ushqen dhe e zmadhon edhe më tepër këtë tendenciozitet. Një nga fushat ku kjo duket më hapur është edhe ajo fetare dhe veçanërisht në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me Komunitetin Orthodhoks. Kjo duket si në heshtjen mbi ngjarjet dhe veprimtaritë e rëndësishme ashtu edhe me trajtimin skajshëm tendencioz të tyre. Të përziera të gjitha këto jo thjesht me injorancën, por me mungesën e dëshirës për të mësuar të vërtetat historike.

Kështu, kohët e fundit po flitet shumë për shtrembërimet që i janë bërë historisë sonë në periudhën e komunizmit, por kur vjen fjala për Kishën përdoren

Tendenciozitet dhe injorancë

me kokëfortësi klishe të rreme që ai krijoi për besimin e klerikët, duke mbyllur sytë edhe përpara të vërtetave historike që tani janë të qarta për këdo, besimtar ose jo.

Gjendja është edhe më keq kur flitet për kanonet dhe ligjet që drejtojnë jetën e një komuniteti fetar. Laiku bëhet prift, prifti dhespot dhe dhespoti... laik... Kështu, një mashtrues, që i leverdis disa politikave të nacionalizmit primitiv, mund të trajtohet me pafytyrësi jo vetëm si «prift», por edhe deri si «episkop» e kryetar kisha dhe askush nuk shqetësohet kur ai vjedh komunitetin apo e kthen pagëzimoren e kishës në tualet!...

Emblematike për këtë sjellje ishte dita e përrurimit të terrenit sportiv të Institutit të Riedukimit «Ali Demi» (burg i sigurisë së ulët). Gjatë një vizite në dhjetor Kryepiskopi Anastas, pasi kishte dëgjuar nevojat e tyre, u kishte premtuar ndërtimin e një terreni sportiv. Pas disa muajsh ai u bë realitet dhe ishte i parametrave bashkëkohorë, me një investim prej rreth 20 mijë USD. Me rastin e përrurimit ishin ftuar dhe mediat, të cilat megjithëse ishin të pranishme, pothuajse nuk dhanë asgjë për kontributin e Kishës, por vetëm intervista për çështje të tjera politike (intervistuan të gjithë funksionarët, për çdo gjë, por jo episkopin orthodhoks, që

preu shiritin në emër të Kishës...). Por kjo nuk ishte thjesht një mungesë profesionalizmi, pasi disa ditë më pas këto media i dhanë vend të gjerë disa shpifjeve ordinere të mashtruesit Nikolla Marku, duke treguar qartë një farë alergjie ndaj Komunitetit Orthodhoks dhe preferencë vetëm për ata që hedhin baltë mbi të.

Tipike, për shembull, për këtë është gjithmonë gazeta «Republika», e gatshme të botojë çdo gjë që flet keq jo vetëm për Kryepiskopin Anastas, por në përgjithësi për Kishën Orthodhokse. Apo gazeta «Shekulli», që jo vetëm preferon shkrimet antiorthodhokse, por megjithëse boton gjithfarë E-mailesh e reagimesh nga lexuesit, injoron sistematikisht ato që mbrojnë Kishën etj.

Th.Dh.

Kisha Orthodhokse e Shqipërisë në vitet e diktaturës komuniste

- 3. Duke imituar Revolucionin Kulturor Kinez: Shpërthimi i terrorit ateist -

(Vijon nga faqja 3)

organizatë-bazë, synonte që t'i shndërronte këta gardistë të kuq shqiptarë në ushtarë të bindur të Revolucionit Kulturor Shqiptar që sapo kishte filluar.

Një ndër problemet kryesore që Enver Hoxha ceku në fjalën e tij ishte indiferentizmi i shfaqur nga organizata-bazë e Portit të Durrësit ndaj një punëtori që punonte mirë ditën, madje lavdërohej për këtë, por që natën bënte ikona (në të vërtetë bënte arabeska dhe jo ikona) dhe ua shiste besimtarëve. Problemi tjetër ishte ai i fejesave dhe i martesave të vajzave të mitura në kundërshtim me ligjin, problemi i cili u gërshetua qëllimisht nga diktatori me luftën kundër fesë, ndërsa thënia e tij për të drejtat e grave u kthye në flamur që do të përligjte dhunën e pashembullt që do të ushtrohej: *Gjithë Partia dhe vendi duhet të ngrihen në këmbë, të djegin me zjarr zakonet prapanike e t'i këputin kokën cilitdo që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të Partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave.*

Për shkak të mjeteve të kufizuara të informacionit, populli u njoh me përmbajtjen e fjalimit të 6 shkurtit nëpërmjet shtypit një ditë më pas. Të nesërmen, në datën 8 shkurt, gazetat e mëdha publikonin në faqet e para iniciativën e shkollës së mesme «Naim Frashëri», të Durrësit, nën titullin agresiv «*Me shpatën e mprehtë të ideologjisë së Partisë kundër ideologjisë fetare, paragjyqimeve, besëtytnive e zakoneve prapanike*». Në fakt «nisma» e këtyre të rinjve, që vepronin nën tutelën dhe kontrollin e plotë të sekretarit të parë të rrethit të Durrësit dhe anëtarit të Byrosë Politike Rita Marko, kishte filluar të ndihej gjatë javës së dytë të janarit, por shumica e nxënësve dhe e mësuesve shprehnin pothuajse hapur pakënaqësinë e tyre ndaj një aventure të tillë. Më 21 janar presioni i ushtruar nga komunistët çoi në organizimin e një mbledhjeje të përgjithshme, ku të rinjtë ngritën një sërë çështjesh si p.sh. suprimimi



Në vitin 1990, edhe ato objekte që nuk ishin shkatërruar qenë të rrënuara.

nga letërnjoftimi i shtyllës në të cilën figuronte besimi fetar, shpronësimi i institucioneve fetare, kthimi i xhamisë së Durrësit në Shtëpi të Rinisë, bashkimi i varrezave që u përkisnin besimeve të ndryshme në një të vetme, heqja nga lajmërimet e martesave dhe të formularëve të telegrameve që përmbanin fjalët «zoti», «zonja», «zonjusha», heqja e festave fetare dhe zëvendësimi i tyre me festa të tjera, ndërrimi i emrave tradicionalë etj. Pas kësaj komunistët i orientuan të rinjtë e kësaj shkolle të vepronin në terren.

Më 2 shkurt 1967, të kremten e Përhasjes së Zotit, të shoqëruar edhe nga disa mësues të tyre, të rinjtë u drejtuan për në fshatin Shën Vlash, ku u organizua një takim me banorët. Ndër të tjera u hodh edhe ideja e kthimit të manastirit historik, i famshëm për «gurin e shenjtë», në qendër kulturore-shëndetësore, por reagimet e vendësve ishin kaq të fuqishme, sa që u arrit deri në përlëshje fizike. Për të penguar masivizimin e protestave kundër fushatës ateiste, regjimi ndërhyri menjëherë në mënyrë brutale. Arrestoi dhe nxori para gjyqit personat që kishin penguar «nismën» e të rinjve të shkollës «Naim Frashëri». Madje në një rast gjyqi u zhvillua në mjediset e kësaj shkolle, kurse nxënësit dhe mësuesit u vunë në rolin e prokurorit.

Më 17 shkurt Enver Hoxha zhvilloi një takim pune në rrethin e Durrësit. Njëra prej dy temave të bisedimeve me krerët partiakë të këtij rrethi ishte «zbatimi i mësimëve të shokut Enver... për

thelimin e iniciativave të masave në luftën kundër zakoneve prapanike në ndërgjegjen e njerëzve». Në pasditen e të njëjtës ditë ai ndoqi një shfaqje teatrale. Në pushim të saj u takua me «revolucionarët e vegjël» të shkollës Naim Frashëri, të cilët i uroi për rezultatet e arritura në luftën kundër ideologjisë fetare dhe i inkurajoi ata për të ecur në këtë rrugë edhe në të ardhmen. Me këtë veprim Enver Hoxha linte të kuptohej hapur se pas «nismave revolucionare të masave» fshihej ai vetë dhe Partia e tij në pushtet.

Siç u përmend edhe më lart, lufta kundër fesë u ndërthur me atë të mbrojtjes së të drejtave të grave, pozita e të cilave në shumë raste linte për të dëshiruar, prandaj dhe në këtë drejtim mbetej me të vërtetë shumë për të bërë. Por a mund të fajësohej për këtë feja? Në qoftë se ishte ashtu siç pretendonin komunistët, atëherë përse shoqëri shumë më fetare se shoqëria shqiptare, si p.sh. shoqëritë e vendeve perëndimore, ishin në të njëjtën kohë edhe shoqëri shumë më të emancipuara për sa i përket mbrojtjes së të drejtave të grave?

Tendencioziteti i luftës për të drejtat e grave për të justifikuar luftën kundër fesë duket edhe nga fakti se edhe kjo «iniciativë» shpërtheu nga Shën Vlashi. Shkak u bë fejesa e një të miture me një burrë të martuar. Sigurisht që ky nuk ishte një rast unik, por regjimit i interesonte ta bënte publik nëpërmjet mjeteve të atëhershme të informacionit, sepse i akuzuari ishte

pikërisht nga Shën Vlasi, nga vendi ku kishte nisur fushata ateiste. Në datën 19 shkurt Kryesia e Bashkimit të Grave të Shqipërisë u bënte thirrje me rastin e 8 Marsit, ditës ndërkombëtare të gruas, «të mos lejonin zakonet e shitblerjes dhe të ndëshkonin fajtorët ashtu siç bënë në Shën Vlash të rrethit të Durrësit». Kuptohet lehtë se thirrje të tilla me rastin e një feste që donte ende gati 20 ditë të vinte, ashtu si edhe përmendja e emrit të «Shën Vlashit» synonin të elektrizonin akoma më shumë atmosferën ateiste që po përfshinte gjithë vendin.

Më 27 shkurt 1967, Komiteti Qendror i PPSH u dërgoi një letër komiteteve të Partisë në rrethe, që i nxiste komunistët t'i jepnin fund çdo forme të dukshme të institucionit të fesë në Shqipëri. Ngjarjet që pasuan janë të njohura nga të gjithë. Regjimi ateist ishte duke kryer krimin më të madh që ka njohur ndonjëherë historia njerëzore: mbytjen e ndjenjës më intime që ekziston në shpirtin e njeriut qysh në embrion, dashurinë për Krijuesin. Më në fund diktatori Enver Hoxha mund të mburrej, (siç u mburr), se akti i tij ishte me të vërtetë origjinal. Ndërkohë, kjo ishte edhe fjala e fundit e tij, në kuptimin që asnjëherë më vonë ai nuk mundi të kryente një krim më të shëmtuar se ky. Megjithatë, me kalimin e viteve, gjërat ndryshuan. Vetëm se kësaj here ishte radha e popullit besimtar të thoshte fjalën e fundit.

Pirro Kondili

(vijon në numrin e ardhshëm)

Himnologjia dhe Muzika Bizantine brenda adhurimit

Zhvillimi i Himnologjisë dhe arritjet e saj në shekuj

Deri në shek. IV, në kishë psalte i gjithë populli njëkohësisht dhe me një zë. Kjo mënyrë e të psalurit quhet në “simfoni” ose me një gojë. Zakonisht gjatë shërbesave tërësia e besimtarëve ndahet në dy kore, në të burrave e të grave. Mënyrë tjetër e të psalurit ishte e ashtuquajtura “nën zë”. Sipas saj psalte vetëm një psalt. Gjatë vargjeve të fundit psalnin bashkë ose psalti një pjesë të vargut dhe populli mbaronte pjesën tjetër, ose psalti të gjithë vargun dhe populli e përsëriste atë që psalte, ose thoshte Amin etj. Gjithashtu një mënyrë tjetër e të psalurit ishte ajo “Andifonike”, kur dy koret psalin me radhë.

Për arsye të pjesëmarrjes së popullit, i cili s’e njhte muzikën, stonaturat ishin të shumta. Për të mënjauar prishjen e atmosferës së lutjes, u caktua krijimi i radhëve të psaltëve në sinodin lokal të Laodikesë (360 pas Kr.), kanoni i 15-të.

Kori përbëhej edhe nga isokratët (mbajtësit e isos), referon Shën Vasili i Madh. Shën Efremit Siriani në Siri, Athanasi i Madh në Aleksandri, Ambrozi në Milano, Vasili i Madh në Azinë e Vogël dhe Joan Gojarti në Konstandinopojë punuan sistematikisht për organizimin e muzikës, por gjatë saj lindën edhe probleme të shumta për sa i përket sistematizimit dhe dhënies së strukturës kësaj muzike në formim e sipër.

Në të njëjtën kohë, në Perëndim, muzika kishtare pati një drejtim tjetër. Atje u fut muzika instrumentale dhe nga fundi i mijëveçarit të parë shfaqet muzika kishtare polifonike, që shoqërohej edhe nga organo kishtare. Krijuesit kryesorë të saj ishin nga fundi i shek. IV, episkopi i Milanos Ambrozi dhe Grigor Dialogu (590-604).

Muzika e Ambrozit u quajt kënga ambroziane dhe mbështetet në tonin ritmik. Ai përcakttoi i pari emërtimet e tingujve: i pari, i dyti, i

treti, i katërti, duke zëvendësuar emërtimet e vjetra dorio, lidio, friggio dhe miksolidio.

Në këtë muzikë u futën dhe elemente të tjera, gjatë shek. të 6-të. Atëherë papa Grigor Dialogu, mori përsipër reformimin e muzikës. Kjo muzikë që u krijua u quajt kënga Gregoriane dhe u vulos në një libër që u quajt “Andifonario”, i cili përmban të gjitha këngët liturgjike dhe ka një mënyrë shkrimi të veçantë.

Muzika grigoriane është monofonike dhe e ngadaltë. Veç katër tingujve kryesorë të Ambrozit shton edhe katër tinguj të tjerë të tërthortë: tërthorin e parë, tërthorin e dytë, tërthorin e tretë (i rëndi) dhe tërthorin e katërt, duke zëvendësuar emërtimet e vjetra ipodorio, ipolidio, ipofriggio dhe ipomiksolidio.

Një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e Muzikës Kishtare Bizantine dhe një veçori që e bën atë shumë të veçantë dhe interesante është sistemi i saj grafik. Ngaqë muzika kishtare në fillimet e saj transmetohej gojarisht nga brezi në brez, është normale që të mos ketë pasur një mënyrë shkrimi të caktuar. Me kalimin e kohës e krijimin e traditës së të kënduarit të himneve kompozitorët filluan që të vendosnin disa shenja të caktuara mbi ose nën tekst, por nuk dihet se me çfarë shenjash konkretisht shkruanin. Që ekzistonte shkrimi muzikor, kjo dëshmohej në kanonin e 16-të të sinodit të Laodikesë (364 pas Kr.). Gjithashtu është e vërtetuar historikisht se të krishterët e Antiokisë në kohën e Shën Efremit Sirianit kishin simiografi muzikore.

Me kalimin e kohës simiografia merr zhvillim dhe kryesisht pas shek. IV, kohë në të cilën zhvillohet takigrafia (shkrim i shpejtë muzikor) nga e ka prejardhjen shkrimi angjistroidik (me grepa). Gjithashtu, pas shek. IV, merr zhvillim një lloj tjetër shkrimi muzikor “simiografia ekfonetike”, që të këndohej me muzikë Apostulli dhe Ungjilli. Këto shenja ishin shumë të thjeshta dhe vendoseshin sipër ose poshtë tekstit të shkruar.

Me kalimin e kohës Muzika Bizantine pati shumë risi, sidomos nga muzika teatrore dhe pati një rrezik të madh që të shkatërrohej. Në këtë çast shfaqet një figurë e madhe, Joan Damaskini “njeri shumë i arsimuar”, i cili bëri një reformë të madhe në muzikën Kishtare. Shën Joani pasi mbledhi të gjitha të dhënat e deriatëhershme, i sistemoi ato.

Nga Shën Joani e këtëj kjo muzikë është përpunuar shumë herë. Është përpunuar në kohën e Joan Kukuzelit nga Durrësi, i cili bëri disa ndryshime në shkrimin muzikor të Joan Damaskinit, që u përdor deri në shek. XVIII. Pas tij Petro Peloponezi, personalitet i muzikës në shek. XVIII, thjeshtoi sistemin e Kukuzelit, si edhe shpjegoi formulat muzikore.

Më vonë, më 1814, dolën tre muzikantë, Krisanthi i Durrësit, Grigor Iambadari, dhe hieropsalti Hurmuzio hartofilaksi, të cilët ndjenë nevojën e një transformimi rrënjësor të shkrimit muzikor të Petro Peloponezit. Këta punuan sistematikisht në mënyrë shkencore e krijuan një metodë të re shkrimi duke huazuar shumë shenja nga muzika evropiane. Me këtë lloj shkrimi e metode u shkruan tekstet e vjetra, si edhe të gjitha pjesët e Joan Damaskinit, Kukuzelit, Peloponezit etj.

Në Konstandinopojë krijohet një shkollë e veçantë e muzikës kishtare, ku mësohet metoda e re. Aty Grigori dhe Hurmuzio kishin anën praktike ndërsa Krisanthi anën teorike, duke shkruar “Teoria e Madhe e Muzikës”, që u botua në vitin 1832. Metoda e re e thjeshtoi shumë mësimin e muzikës dhe anën e saj praktike.

Kjo metodë shkrimi muzikor vazhdon të përdoret edhe sot e kësaj dite në partiturat e muzikës bizantine, e cila ka një fuqi shprehëse dhe lutëse shumë të madhe. Shpirti i njeriut nëpërmjet tingujve melodikë të zërave që shqiptojnë himnet adhuruese ndaj Perëndisë, ngjitet lart pranë engjëjve dhe bashkë me ta duke simbolizuar edhe ne Keruvimet dhe Serafimet i psalim pa pushim Perëndisë “Shenjt, Shenjt, Shenjt je, o Perëndia ynë. Amin”.

*Dhjakon Spiro Kostoli
Pedagog i Muzikës Bizantine
në Akademinë Teologjike*

Shën Joan Kukuzeli (1 tetor)

Lindi në Durrës, rreth 1270, sipas të dhënave më të fundit. Nënshkruhet dhe Papadhopulos, pra do të ketë qenë djalë prifti (papa = prift). Nëna e tij shpresëtare e dërgoi në shkollë në Konstandinopojë, ku u tregua “mjeshtër”, mësonjësi i muzikës dhe drejtues i korit të pallatit mbretëror.

Meqë perandori, i cili e donte shumë, do ta martonte me një vajzë arkondi, ikën fshehurazi në Lavra, duke bërë në mënyrë inteligjente çobanin. Një herë, kur kulloste dhinë në një vend të shkretë, filloi të psalte. Por një murg që rrinte në shpellë pa u parë, u magjeps nga melodja, doli dhe pa



kafshët që nuk kullotnin, por shijonin të magjepsura! Ky ishte oshënari i kërkuar kudo! Mbreti u përbot sapo e mori vesh nga igumeni, i cili shkoi dhe iu lut që të mos e shqetësonte murgun, kështu që nuk e ngacmoi.

Më vonë u ushtrua në një qeli (manastir i vogël) që ndërtoi jashtë Lavrës, vetëm të dielave dhe për festa vinte brenda.

Në një agripni të madhe të Akathistit psalti i parë zë engjëllor dhe “i hirshëm” dremiti pak, kështu që iu dha dhuratë nga e Tërëshenjta një monedhë, të cilën kur u zgjua e mbante vërtet në duart e tij! Por ia ktheu. Domethënë e vari në ikonën e saj, që është e famshme deri më sot. E Tërëshenjta vetë shëroi këmbën e tij të kalbur nga të qëndruarit drejt në psaltir.

Paranjohu fundin e tij. Koka nderohet në manastirin e tij.

Sistemoi dhe riformoi melodi më të vjetra të tij, kompozoi tërësi veprash origjinale të famshme, kryesisht “kalofoni të ngadalta mësimesh”, në mënyrën tradicionale. Pothuajse të gjitha u përkthyen në shkrimin muzikor të përdorimit. Gjithashtu kompozoi metoda të psaluri dhe himne.

Atë Justini (Nga libri “Nga thesari i shenjtoreve”)

Kryepiskopi Anastas i dhuron të dënuarve një fushë sportive



(vijon nga faqja 1)

Por kjo nuk qe dhurata e parë e Kryepiskopit Anastas për këtë institucion. Në vitin 2001, ai kishte kontribuar po në këtë burg edhe ndërtimin e një serre lulesh dhe perimesh, në regjimin e grave.

Me rastin e përfundimit të punimeve, drejtorja e IEDP "Ali Demi" organizoi ceremoninë e përirimit të fushës sportive në regjimin e burrave. Në ceremoninë e rastit mori pjesë Episkopi i Krujës Andoni, Avokati i Popullit z. Ermir Dobjani, Drejtori i përgjithshëm i burgjeve, z. Arjan Shehri dhe përfaqësues të institucioneve që ndjekin problemet e të dënuarve.

Drejtoresha e burgut, znj. Marinela Sota, në fjalën e hapjes së ceremonisë ndër të tjera tha: "Ne jemi shumë të kënaqur me këtë që është realizuar, sepse këtu vuajnë mosha të reja që kanë nevojë të lëvizin fizikisht. Gjatë vizitës që bëri Kryepiskopi Anastas në institucionin tonë, te regjimi i grave dhe i burrave, ne i kërkuam të na mundësonte ndërtimin e një fushe ku të dënuarit të mund të luanin dhe të kalonin kohën e lirë

duke patur parasysh edhe veçantinë e këtij institucioni, ku të dënuarit mund të luajnë gjatë gjithë ditës e të qëndrojnë në ambiente të hapura..."

Shiriti i përirimit u pre në emër të Kryepiskopit Anastas nga Episkop Andoni, drejtori i përgjithshëm i burgjeve, z. Shehri. Pas kësaj, drejtori Shehri tha duke përshëndetur të pranishmit: "Falënderoj Kishën Orthodhokse dhe vetë Hirësinë e Tij, zotin Janullatos, për këtë ndihmë të çmuar që i ka dhënë sistemit të burgjeve në Shqipëri. Kjo hyn në kuadrin e përpjekjeve tona të vazhdueshme për të lehtësuar sa më shumë jetesën e të dënuarve në burgjet shqiptare. Kjo është në kuadër të reformës që ne kemi ndërmarrë në sistemin penitenciar me fondet e qeverisë, me fondet e drejtorisë, por edhe me bashkëpunimin e ngushtë me donatorët, siç është rasti konkret. Edhe njëherë falënderoj Kishën Orthodhokse që ka bërë këtë dhuratë dhe ju ftoj që ta shfrytëzoni maksimalisht këtë ambient me të vërtetë shumë të bukur".

Pastaj e mori fjalën Imzot Andoni i cili tha: "Sjell përshëndetjet dhe urimet e Krye-

piskopit Anastas. Në këto çaste nuk mund të ndodhej me ju, por ashtu siç jua dha fjalën, ndërtimi i kësaj fushe u realizua. Gëzohemi që është e një cilësie të mirë. Kisha Orthodhokse në radhë të parë do të tregojë që është së bashku me ju. Ju nuk jeni vetëm në këtë ambient. Është detyra jonë dhe e çdo besimtarit që të jenë pranë atyre që janë në kushte apo në një situatë të vështirë".

Shefi i kujdesit social në burgun 325, z. Përparim Gjyshja, pyetjes sonë se sa e rëndësishme është ky terren në punën tuaj, na u përgjigj: "Në fillim dua t'ju falënderoj për këtë investim që ka bërë Kisha Orthodhokse. Nuk është hera e parë që Kisha bën investime të këtij niveli. Ka bërë një investim te regjimi i grave për ndërtimin e një serre dhe vazhdimisht na ndihmon me bazë materiale. Në qoftë se shihni sot këtë terren me tapet të gjelbër, dikur ishte me gurë dhe ujë ku të dënuarit shkolin të argëtoheshin dhe dëmtoheshin. Mjedis sportiv do të na hyjë në punë, sepse këtu ka dënime të pakta dhe mosha përgjithësisht të reja dhe argëtimi kryesor i tyre janë aktivitetet sportive. Konkretisht, kemi filluar kam-

pionatin e minifutbollit midis dhomave dhe në vazhdim do të përdoret edhe për volejbolle dhe basketboll".

Së fundi ky investim i Kishës sonë solli edhe një përfitim tjetër social për disa prej banorëve të këtij Instituti Edukimi, sepse punësoi disa prej tyre, të cilët punuan me shumë qejf, duke zhvilluar më tepër edhe

ndjenjën e ngrohtësisë e miqësisë midis tyre dhe njëkohësisht përfituan një pagë për punën e bërë.

Ceremonia u mbyll me një koktejl dhe një ndeshje futboll në këtë fushë të re, midis një skuadre të këtij Instituti me atë të burgut të Zallherit.

Julia Pjetri
Thoma Dhima

Kontribut dhe kujdes i vazhdueshëm i Kishës për të dënuarit

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë financoi, po në këtë burg, në vitin 2001, edhe ndërtimin e një serre lulesh dhe perimesh, në regjimin e grave. Prodhimet nga kjo serrë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë ndihmë për vetë të dënuarat. Serra është njëkohësisht edhe një ndihmë nga ana psikologjike, pasi koha që kalojnë duke punuar në këtë mjedis i ndihmon të jetojnë më ndryshe momentet e vështira që mund të kalojnë.

Por këto vepra janë veprat më të dukshme, që Kisha jonë ka bërë për këta njerëz në vështirësi. Vizitat dhe ndihma për të dënuarit është e vazhdueshme, e përmuajshme, sidomos nga Lidhja e Grave Orthodhokse "Përhapja e Dashurisë: dhe nga Rinia Orthodhokse. Janë rreth 10 vjet që ka nisur bashkëpunimi me këtë Institut, ku Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë ka ndihmuar materialisht e shpirtërisht, duke bashkëpunuar me stafin dhe drejtorinë, bashkëpunim ky që ka qenë përherë dhe më i ngrohtë e rezultativ. Me bekimin e Kryepiskopit Anastas dhe kontributin e tij, ky aktivitet dhe kjo ndihmë filloi dhe vazhdon të kontribuojë në ringritjen shpirtërore të të burgosurve.



Në kuadrin e 1600-vjetorit të fjetjes


KISHA TRIUMFUESE

Nga Shën Joan Gojarti

Është e fortë dallga dhe të shumta janë valët që po na rrethojnë e që na turren. Po s'kemi fare frikë se mos mbytemi: sepse qëndrojmë mbi një shkëmb që nuk thyhet e nuk epet kurrë. Me tërbim të patreguar vërsulet e lëshohet deti: po këtë shkëmb as ka mundur, as do të mund ta copëtojë ndonjëherë!

Me të vërtetë, nuk më thua: Ç'gjë mund të na trembë? Mos është vdekja? Aspak. Për mua jeta është Krishti dhe vdekjen e quaj jo fatkeqësi, po përkundrazi, gjë të mirë dhe fitim të madh. Mos do të na frikësojë internimi? Po toka e tërë anembanë është e Zotit! Apo mos na tmerron humbja e të hollave? Vëlla i dashur, dihet se asgjë nuk sjellim me vete kur vijmë në këtë botë; të jesh i sigurt, se edhe kur të dalim prej saj, nuk do të marrim dot asgjë e nuk do të shoqërohemi prej asgjëje. Mjerimet e tmerrshme që ka kjo botë, përbuzen prej meje dhe nuk përfillen fare, gjithashtu edhe gëzimet që na sjell herë pas here nuk ushtrojnë as më të voglin ndikim mbi mua. Nuk kam frikë nga vobekësia, s'e dëshiroj pasurinë: s'më tmerron vdekja, e në qoftë se dëshiroj të jetoj, këtë e bëj jo për tjetër gjë, por vetëm e vetëm që t'ju forcoj sa më tepër në besën tuaj.

Prandaj ju flas sot për gjendjen e keqe - sikurse mund ta quajë dikush prej jush - dhe ju lutem të mos dëshpëroheni aspak, por të kini kurajë dhe besim të patundur te Zoti. S'ka asnjë fuqi në botë që t'ju përçajë dhe tju ndajë e t'ju largojë nga Kisha: sepse atë që bashkoi dhe e lidhi Perëndia, njeriu nuk mund ta ndajë në asnjë mënyrë. E në qoftë se martesën nuk mund ta prishësh, ti Satana, si guxon të besosh, se do të mundësh ta përçash e ta shkatërrosh Kishën e



Shën Joan Gojarti, basoreliev bizantin i shek. XI, në muzeun e Luvrit.

Perëndisë? Është e vërtetë, se ti nuk pushon së luftuari këtë; po mundohesh më kot: se sa më tepër luftohet ajo, aq më e fortë dhe më e shkëlqyer del. Pushoje pra këtë luftë, o i çmendur, nëse dëshiron të mos shuhet krejt fuqia jote: se sigurisht, ka për të ngjarë, në qoftë se ti nuk heq dorë nga kjo luftë. Kur lufton me njerëz, mund të kesh shpresë që të dalësh fitues e mundës: po me qiellin a mund të matet dikush, qoftë dhe më i fuqishmi i botës?

Fuqia e Kishës është e pathyeshme, se Zoti vetë e ka krijuar e themeluar: apo mos kujton, or armik i endur, se je i zoti t'i dalësh Perëndisë ballë për ballë? Kisha, dhe dije mirë këtë, është më e fortë dhe nga qielli vetë. Ky i fundit bashkë me token do të kalojnë e do të zhduken, po fjalët e Zotit nuk do të humbasin e nuk do të përgë-

njestrohen kurrë. Cilat fjalë? "Se portat e Ferrit nuk do ta mundin dot Kishën".

* * *

Nëse nuk do të besosh në fjalët, atëherë beso në realitetin e në punët. Sa tiranë kanë dashur ta shkatërrojnë Kishën? Sa kamina, sa dhëmbë egërsirash, sa shpata të mprehta? Me gjithë këtë s'mundën t'i bëjnë asgjë. Nuk më thua: ku janë armiqtë e saj? Janë fshehur, janë lënë në heshtje e në harresë të plotë. Po Kisha ç'u bë? Ajo ndrit e shkëlqen më shumë dhe se dielli: e ky do të shuhet e do të zhduket një ditë, po ajo ka për të mbetur përjetë dhe e pavdekshme. Ç' thotë historia kishtarë? Thotë se Kisha nuk u mund kur ishte e vogël dhe besnikët ishin të pakët; si do të mundet tashti, kur tërë bota është mbushur me besnikë e me pasues të saj? Dielli e dheu do të kalojnë e do të zhduken, po fjalët e Tij kurrë. Dhe është kjo shumë e arsyeshme; mbasi Perëndia e do Kishën më tepër sesa qiellin. Zoti, duke zbritur në tokë, nuk mori trup qielli, po mish kishe. Për Kishën u bë dhe qëndron qielli, dhe jo Kisha për qiellin.

* * *

Le të mos ju tronditë asgjë nga ato që ngjanë këto ditë. Vetëm një gjë ju lutem të më falni: besë të patundur. Nuk mbani mend se ç'ngjau me Petron, kur shkonte ky mbi ujërat? Mend u mbulua nga valët, jo se këto ishin të fuqishme shumë, por se shfaqti një dyshim të vogël dhe tregoi kështu besë jo të fortë. Po ju pyes, vëllezër të dashur: mos kini ardhur këtu me vota e me dëshira njerëzish? Mos na solli këtu fuqi njeriu, që të kemi frikë, se mos fuqi njeriu na shkatërroi?

Nuk i them këto me krenari e me mburrje, Zoti mos e dhëntë, po i them se dëshiroj t'ju forcoj në besën tuaj, që u trondit ndoshta nga ngjarjet e fundit. Meqenëse qyteti qëndroi në këmbë dhe s'pësoi gjë, u kthye djalli kundër

(Vijon në faqen 8)

Jeta e Shën Joan Gojartit, Krisostomit (354 - 407)

U lind në Antioki (354). E ëma, Anthusa, në moshën njëzet-vjeçare varrosi të shoqin gjeneral, që ishte edhe ai i krishterë, dhe mbeti gjithmonë e ve për hir të Krisostomit (greqisht = Gojarti).

Në moshën trembëdhjetëvjeçare ai braktisi shkollën e oratorit idhujtar Livan (i cili më pas donte ta shpallte pasardhës të tij, nëse nuk do të ishte i krishterë) dhe studioi për theologji.

U pagëzua në vitin 372, ndoshta nga Shën Meleti i Antiokisë (12 shkurt). Pas tre vjetësh i thanë të bëhej prift, por ai iku. U bë murg pranë një jeronti dhe dy vjet të tjera qëndroi i vetëm në një shpellë. Por u kthye në vitin 380, sepse nga ushtrimi i madh, vuante nga veshkat. Meleti e hirotonisi dhjak (381) dhe pasardhësi i tij e bëri presviter (386).

Shën Joani fliste vazhdimisht, interpretonte Shkrimet e Shenjta, mbështeste njerëzit, i ruante nga herezitet, zhvillonte vepra bamirësie. Fitoi kudo nam dhe admiruesi i tij, kryeministri Eftropi, (i cili më pas u bë armiku i tij), e solli në Konstandinopojë, duke manovruar, që të mos kundërshtonte. Kështu, më 15 dhjetor 397 u dorëzua kryepiskop i saj.

Predikonte dhe duartrokitej; udhëhiqte, organizonte dhe drejtonte misionarizmat - edhe pse më vonë i internuar - ngrinte spitale, azile pleqsh, shtëpi për të varfrit ku shërbenin dhjakoneshat e shën Olimbiadhës (25 korrik). Shenjti ka bërë shumë pjesë të Liturgjisë së tij, si dhe kumtesa, letra dhe sidomos omeli.

I papajtueshëm ai godiste madje edhe vetë mbretëreshën Evdhoksia - kështu Kisha do ta humbiste shpejt. Udhëtonte dhe shkarkonte klerikë të padenjë (401) por, duke përdorur këtë gjë si shkas ("ndërhyrje në juridiksionin e huaj"), armiqtë e tij e shkarkuan me sinodin në Dhrin (403). Ndërkaq revolta popullore dhe ngjarje të shënuara në pallatet mbretërore, ia pezullojnë internimin.

Por, ai përsëri kontrollonte mbretëreshën, kështu që u internua (404) në Kukuso të Kapadhokisë. Ndërsa kalonte në Komana të Pontit të Azisë së Vogël, dha shpirt nga mundimet (14.9.407), ditën e Lartësimit të Kryqit.

Kremtohet edhe më 30 janar, ndërsa transferimi i lipsanit të tij, që u bë në vitin 438, kremtohet më 27 janar.

KISHA TRIUMFUESE

(vijon nga faqja 6)

Kishës dhe u mundua ta tundë e ta rrëzojë. Djall' i keq dhe i urryer! Mure nuk munde të tronditësh, e shpreson të rrëzosh një kishë të tërë? Mos kujton se Kishën e bëjnë muret? Aspak. Besnikët janë ata që e mbajnë dhe që e ruajnë. Shih këtu sesi qëndrojnë të patundur e të palëvizur, jo se i shtrëngoi hekuri dhe pranga, por se i lidh besa dhe shpresëtaria. Nuk them se një shumicë aq e madhe është më e fortë dhe nga zjarri: po edhe një sikur të ishte, prapë nuk do ta mundje dot. Ti e di mirë, se sa plagë të kanë shkaktuar martirët e dëshmorët. Shpeshherë ka hyrë në kishë vajzë e vogël nga mosha; kur hyri ishte më e butë se qiriri, po kur doli u tregua më e fortë dhe se guri. Brinjët e saj i gërmitë dhe shpove, po besën e saj nuk munde ta rrëmbesh ose ta dobësosh. Mishi u dobësua, por fuqia e besës mbeti e padobësuar: trupi shkatërrohej, por zemra e shpirti bëheshin më të rinj dhe më të fortë: lënda zhdukej, por shpresëtaria qëndroi e patundur. Një grua nuk pate fuqi ta mundësh: si pret të mundësh një shumicë aq të madhe? Nuk dëgjon se ç'thotë Zoti? Atje ku janë mbledhur dy ose tre në emrin Tim, atje dhe Unë jam në mes tyre. Kur pra jemi aq shumë të bashkuar me anën e dashurisë, si mund të mungojë e të ndodhet midis nesh Krishti?

Do të më pyesni ndoshta: ku bazohem që flas me aq siguri të madhe? Po ju përgjigjem: Unë, vëllezër të dashur, kam në dorë një kontratë me Zotin. Ju duket ndoshta e çuditshme? Nuk është aspak e çuditshme, po është krejt e vërtetë dhe e sigurt. Them se kam në dorë kontratën me Zotin: kjo kontratë për mua është shkopi ku mbështetem, është sigurimi im. Kjo është limani pa valë e pa dallgë. Sikur tërë bota të tronditet e të tundet, unë e mbaj këtë kontratë, e lexoj dhe shkronjat e saj janë për mua mur i fortë e fortesë e papushtueshme. E cila është kjo kontratë dhe cilat janë këto shenja? Ja: "Unë jam bashkë me ju çdo ditë e gjer në mbarim të shekujve". Është Krishti me mua: ç'frikë do të kem? Sikur tërë valët e detit të turren kundër meje, sikur të vërsulen kundër meje tërë zemërimet e kanosjet e të fuqishmëve të dheut, unë nuk do të tundem aspak, se këto për mua janë më të dobëta dhe nga pluhuri i merimangës.

Të mos më shtynte dashuria që kam për ju, as sot nuk do të kisha vendosur të nisem. Se gjithnjë them: "O Zot, dëshira jote u bëftë: jo ç'kërkon njëri e tjetri, ç'kërkon Ti. Perëndia është për mua shkëmb i pathyeshëm: nëse Perëndia dëshiron të bëhet kjo, le të bëhet menjë-

herë. Në qoftë se dëshira e Tij është që të qëndroj unë këtu, e pranoj me mirënjohje: po të dëshirojë të shkoj gjetkë, e pranoj me falënderime...

* * *

Asgjë, pra, le të mos ju tmerrojë: kini besë të kthjellët dhe mos u largoni kurrë nga lutjet dhe nga litanitë. Djalli ka dashur dhe është munduar t'ju largojë nga këto: po s'bëri dot gjë. Përkundrazi, unë sot ju gjej më të zellshëm e më të nxehtë në besën. Nesër bashkë me ju do të dal për të bërë litani të madhe. Atje ku jam unë, dhe ju do të jeni: ku jeni ju, dhe unë: një trup jemi. Vendi mund të na ndajë e të na largojë, po dashuria na bashkon e na mban afër, dhe këtë dashuri as vdekja vetë nuk do të mund ta prishë. Edhe trupi im do të vdesë, do të qëndrojë gjallë shpirti im, i cili do ta kujtojë grigjën e tij gjithnjë. Si mund t'ju harroj dhe mos t'ju kujtoj përherë? Ju jeni për mua prindër, ju jeni jeta ime, ju jeni për mua gëzimi.

Me të vërtetë; përparimi juaj është për mua pasuri dhe jetë. Për ju -si bariu që jam-jam gati të vritem e të copëtohem një mijë herë, dhe sikur të kisha një mijë krerë, do t'ia jepja xhelatit me një kënaqësi të madhe. Sepse një vdekje e tillë është për mua burim e shkak pavdekësie: gjithashtu edhe sulmet e shumëllojshme, që bëhen kundër meje, unë i quaj si mjete sigurimi e mbrojtjeje. Sepse e dini për ç'arsye më ndjekin e mendojnë keq për mua? Jo sigurisht për të holla, as për ndonjë gabim, po për shkak të dashurisë që kam për ju: më ndjekin se unë bëj çmos, që të qëndroni ju në siguri të plotë e të mos hyjë njeri i keq në mes të grigjës e të kërkojë ta prishë dhe ta shkatërrojë. Kjo luftë e kjo përpjekje për ju, është kurorë për mua, shumë e vlefshme. Se ju jeni për mua gjëja më e rëndësishme dhe më e ëmbël, madje më e ëmbël dhe nga drita e diellit. E me të vërtetë: Ç'rëndësi ka rrezja e diellit përpara dashurisë suaj? Rrezja e diellit më ndihmon dhe më është e dobishme për këtë jetë, kurse ajo juaja më përgatit e më thur kurorë për jetën e ardhme e të amshuar.

Kini mbetur pa gjumë aq ditë me radhë, po me gjithë këtë asgjë nuk ju tronditi e nuk ju theu: as koha, as frika, as frikësimet: të gjitha i kini bërë edhe një gjë, të cilën unë gjithnjë e kam dëshiruar ditë e natë: i përbuzët tërë sendet e kësaj toke, mohuat dhënë dhe u bëtë bij të qiellit. Këto për mua janë kurorë, këto janë ngushëllim, këto janë jetë, këto më në fund janë shkak e burim pavdekësie.

(Marrë nga libri "Nga kryeveprat e Joan Gojartit", viti 1944, shqipëruar nga Prof. S. Papahristo)

Fjalë të arta nga Shën Joan Gojarti

"Nëse do të thuash për veten tënde se ke emër të mirë, u rrëzove menjëherë dhe u bërë i pavlefshëm, edhe në rastin kur je i mirë. Nëse karakterizon veten tënde të pavlefshëm atëherë u bërë i vlefshëm edhe nëse nuk je i mirë. Sepse ashtu si di t'i kundërvihet fodullëkut, në të njëjtën mënyrë Perëndia di t'u japë hirin e Tij të përlururve."

* * *

"Kuptoje, i dashuri im, se nga sa kopshte dhe livadhe lule stolisur, më e bukur është për dikë të shikojë në mesnatë qiellin me yje. Dhe sikurse do shikojë qiellin, me mrekullim do të konstatojë se ashtu si nëpër livadhe lulet ndryshojnë nga njëra-tjetra ashtu edhe yjet zbukurojnë hapësirën qiellore secili në mënyrë të ndryshme duke dërguar ndriçim të veçantë mbi tokë. Këtë ndritshmëri e stolisi dora e plotfuqishme e Krijuesit."

"Nëse dikush sheh një veshje menjëherë mendon rrobaqepësin dhe nëpërmjet anijes kujton konstruktorin e saj. Gjithashtu, duke parë një ndërtesë, kupton se dora e një konstruktorit e ndërtoi dhe e mirëmban. Me pamjen e krijimtarive truri ynë prek krijuesin e tyre, veçse disa edhe pse i shohin krijimet e Perëndisë në botë nuk kuptojnë krijuesin e tyre, sepse vuajnë nga verbëri shpirtërore."

* * *

"Për shpëtimin tënd, nuk mjafton të dhurosh në Kishë Potir të Shenjtë me gurë të çmuar!.. Nëse do që të nderosh Krishtin, T'i dhurosh shpirtin tënd. Për atë u kryqëzua. Bëje atë të artë. Atë dëshiron.

Nëse shpirti yt vazhdon të jetë plumb dhe baltë e ndyrë, çfarë do të të vlejë Potiri i Shenjtë prej ari?

Pra, jo enë të shenjta prej ari dhe të çmuara, por së pari shpirtin të artë. Këto do Krishti. Dhuratat tuaja të jenë të ardhura të ndershme; nga duar të pastra.

Kisha nuk është argjendari.

Panair engjëjsh është! Shpirtin të pastër! Shpirtin të artë."

* * *

"Dashuria është virtyti më i madh. Është më e madhe edhe se vetë martirizimi. Dhe ja përse: pa martirizimin, dashuria shpëton. Pa dashurinë, martirizimi nuk vlen për asgjë."

TIRANE

Takim i Federatës Rinore Orthodhokse të Ballkanit

Nga 28 shtatori deri më 1 tetor, në qendrën shpirtërore-arsimore "Thavor", në Tiranë, u organizua **takimi i bordit drejtues të Federatës Rinore Orthodhokse të Ballkanit**. Qëllimi ishte që të bëhej vlerësimi i veprimtarive rinore që u organizuan gjatë këtij viti dhe të diskutohet mbi ato që do të zhvillohen më 2008-n.

Gjatë vitit 2007 u organizuan aktivitete të ndryshme si konferenca, trajnime mbi katekizmin, pelegrinazhe në vende të ndryshme fetare dhe turistike në rajonin e Ballkanit, një kamp 15-ditor për të mësuar mbi artin e ikonografisë etj.

Shumë të rinjve, që janë anëtarë të Lidhjes sonë rinore Orthodhokse "Bij të Dritës", iu është dhënë mundësia që të marrin pjesë në këto aktivitete. Dhe siç shprehen ata, këto veprimtari kanë ndihmuar që të forcojnë lidhjen midis të rinjve të vendeve të ndryshme, edhe çka është më e rëndësishme të njihen më mirë me traditat fetare e kulturore.

Edhe viti 2008 do të jetë i mbushur me aktivitete në gjithë rajonin e Ballkanit, si:

- Pelegrinazh në vendet fetare dhe kulturore të Jugut të Shqipërisë.

- Dita e librit, një veprimtari në të cilën do të ekspozohen të gjitha botimet e Kishave Orthodhokse në rang ballkanik. Vendi organizator do të jetë Bullgaria.

- Rumania do të vazhdojë edhe më 2008 me organizimin e kampit të ikonografisë, ku pjesëmarrësve në këtë aktivitet do t'u jepet mundësia të mësojnë dhe të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në këtë fushë.

- Për të gjithë ata të rinj, të cilët kanë dëshirë që të njohin më shumë mbi jetën murgërore, do të organizohen vizita dyjavore në disa prej manastireve më të njohura në Greqi etj.

Takimi u mbyll me falënderimet e përzemërta që iu drejtuan në radhë të parë Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë për mikpritjen e ngrohtë dhe veçanërisht Fortlumutrisë së Tij, Kryepiskopit Anastas.

M. Marini

Kujdes i veçantë i Kishës për fëmijët

U zhvilluan kampet ditore me temë "Të rritemi me Krishtin"

Edhe këtë vit, me bekimin e Fortlumutrisë së Tij Kryepiskopit Anastas, në shumë enori të Kishës sonë u zhvilluan kampet ditore njëjavore me temë qendrore "Të rritemi me Krishtin".

Këto kampe u zhvilluan në fund të gushtit dhe në fillim të shtatorit me pjesëmarrje të gjerë të fëmijëve orthodhoksë të drejtuar nga priftërinjtë e çdo kisha, katekistët dhe shumë vullnetarë të rinj. Programi i kampit ishte nga ora 08⁰⁰ deri në 12⁰⁰.

Çdo ditë e kampit niste me lutjen e mëngjesit dhe vazhdonte me bisedën shpirtërore, punën e dorës, këngët etj. Temat shpirtërore ishin: "Të rritemi në besim", "Të rritemi në të vërtetën", "Të rritemi në dashuri", "Të rritemi në mendime, fjalë dhe vepra".

Në Tiranë, në datat 20-26 gusht, u organizua kampi

ditor në dy qendra: para-dite në mjediset e kopshtit "Ungjillëzimi" dhe pasdite në ato në rrugën "Qemal Stafa".

Në Kavajë kampi ditor u organizua nga data 27 gusht-2 shtator, në mjediset e kishës "Shën Nikolla". Sipas moshës, fëmijët u ndanë në 3 grupe. Kjo ishte një mundësi për ta jo vetëm për të mësuar më shumë

rreth besimit, por edhe për t'u argëtuar, pasi përveç mësimëve për besimin, zhvilloheshin edhe lojëra të ndryshme.

Në Shkodër, mbi 50 fëmijë morën pjesë në aktivitetet e zhvilluara në qytet dhe në Vrakë.

Nga 24-31 gusht një kamp u zhvillua edhe në (Vijon në faqen 10)



VLORË

Rihapet kampi i Skrofotinës

Kampi i Skrofotinës ngrihet pranë një kodre të vogël në fshatin me po të njëjtin emër, pranë rrugës kombëtare Fier-Vlorë, pranë kishës së Shën e Premtes. Në pjesën perëndimore ndodhet kriporja e Vlorës dhe më tej horizontit duket laguna e Nartës bashkë me ishullin e bukur të Zvërnecit. Kërkesat e shumta që kishin të rinjtë për të marrë pjesë në kampet e Kishës sonë dhe pamundësitë për të pranuar një numër të madh kampistësh në

Kapaciteti i kampit, që u zhvillua në gusht, është 43 vetë, por mendohet që në të ardhmen të rritet, pasi mjedis është i mjaftueshëm dhe me kushte komode. Në të morën pjesë të rinj nga zona të tjera dhe fëmijë nga fshati i Skrofotinës. Ata u bashkuan në lutjet e përbashkëta drejtuar Perëndisë, duke marrë pjesë gjithashtu edhe në programet e tjera sportive dhe argëtuese.

Këto ditë çlodhëse në kampin e Skrofotinës iu dhanë mundësinë të rinjve të



kampin e Zvërnecit, u realizuan me hapjen e një kampi të ri në qytetin e Vlorës.

Ai nuk u ngrit aty rastësisht, por për të vazhduar një nismë të ndërprerë prej disa vitesh. Ishte viti 1996 kur aty u zhvillua për herë të parë kampi i vajzave. Problemet që kaloi vendi ynë në vitin 1997 çuan në ndërprerjen e tij, ndërsa në vitin 1999 në rrethinat e tij u strehuan rreth 800 kosovarë. Kaluan disa vite për të ardhur te ky çast, kur kampi rihapi dyert e tij.

kishin një hapësirë më të madhe kohore për meditim dhe të falënderonin Perëndinë për të gjithë të mirat që Ai jep, në çdo aspekt të jetës, ku një shërbim i veçantë është edhe koha e kampeve verore që organizon Kisha. Ky kamp i ri dhe frytdhënës është vazhdim i kontributit për rininë e Kryepiskopit Anastas, i cili e rivendosi në funksion përsëri pas një ndërprerje të gjatë.

*Emanuel Pupi
Anesti Kepi*

Adresat e faqeve në Internet dhe e E-mailit, të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, janë:

Internet: www.orthodoxalbania.org
E-mail: orthchal@orthodoxalbania.org

Dy kampe rinore në Sarandë

Këtë vit në manastirin e Shën Gjergjit, në Çukë të Sarandës, u zhvilluan dy kampe me të rinjtë orthodhoksë të Mitropolisë së Gjirokastrës. Tema kryesore e tij ishte marrë si pjesë e shërbesës së Pashkës: "Tani të gjitha u mbushën me dritë", duke iu referuar edhe librit me të njëjtin titull që ka botuar Kryepiskopi Anastas. Tema fokusohej rreth Dritës, të cilën duhet ta kemi ne si besimtarë dhe këtë dritë nuk duhet ta mbajmë për vete, por duhet t'ia japim dhe të tjerëve.

Kampi i parë përbëhej nga nxënës të shkollës së mesme profesionale "Frymë Dashurie", në



Mesopotam dhe të rinj nga Përmeti. Ndërsa në kampin e dytë morën pjesë nxënës të Liceut Kishtar "Kryqi i Nderuar", në Gjirokastrë.

Dita e kampit niste me Shërbesën e Mëngjesores dhe më pas të

rinjtë zhvillonin një bisedë shpirtërore, duke folur secili për shenjtin e grupit të tyre. Më pas kishte aktivitete të ndryshme sportive, kohë argëtimi, plazh në ujërat e Jonit, konkurse etj.

Gjirokastrë - vazhdoi kampi i Glikomilit

Me bekimet e Mitropolit të Gjirokastrës, Dhimitrit, në kampin e Glikomilit në Dropull, u pritën më shumë se 200 fëmijë (djem dhe vajza), në periudha të ndryshme. Një kamping triditor u organizua gjithashtu për nëna të reja nga Gjirokastra dhe Dropulli.

Motoja qendrore e kampingut ishte: "Hierapostoli në gjurmët e Krishtit", i marrë nga libri i Kryepiskopit tonë që qarkulloi kohët e fundit.

Fëmijët dhe të rinjtë pjesëmarrës patën rastin të përjetonin përvoja të bukura, por më kryesorja ishte

se përjetuan dhe morën pjesë në dy mistere të hirshme të Kishës sonë: të Rrëfimit dhe Kungimit Hyjnor.

Marrë nga "Enoria Jonë", buletin informativ i Mitropolisë së Gjirokastrës

Kujdes i veçantë i Kishës për fëmijët

(Vijon nga faqja 9)

qytetin e Gramshit, me më shumë se 100 pjesëmarrës. Fëmijët u mblodhën në kishën "Metamorfoza e Shpëtimtarit". Kampi niste me Shërbesën e Mëngjesit, komentit e Ungjillit të ditës, mësim kënge, biseda shpirtërore, lojëra të ndryshme, punë dore etj. Gjithashtu u organizuan ekskursionet në pika të ndryshme të qytetit, por ai më mbresëlënësi ishte në Manastirin e hirshëm të Shën Vlashit.

Nga 13 deri më 22 gusht aktiviteti u organizua në zonën e Gjinarit. Në këtë kamp morën pjesë rreth 120 fëmijë. Temat u zhvilluan nga katekistë dhe studentë të Akademisë Teologjike. Megjithatë këta fëmijë jetojnë në një zonë të thellë malore treguan sa e duan Perëndinë dhe u shprehën mirënjohës ndaj Kishës dhe Kryebariut të saj, i cili u mundësoi këtë aktivitet.

Duke parë që në zonat rurale ka mungesë aktivitetesh, Kisha

Orthodhokse organizoi një kamp veror edhe në zonën Mëlizë-Shelcan, ku morën pjesë 65 fëmijë të këtyre fshatrave. Programi ishte i larmishëm; me shërbesa kishare, këngë kishare e popullore, tema sociale dhe shpirtërore, puna e dorës etj. Në kamp u organizua një marshim në kishën e Shën Nikollës, si dhe një ekskursion në Manastirin e Shën Vlashit, në Durrës. Një kamp i tillë u realizua në fshatin Kuqan të komunës Shirgjan, ku morën pjesë 58 fëmijë.

Në Mitropolinë e Beratit këto kampe ditore u zhvilluan në fund të gushtit dhe në fillim të shtatorit në Poro të Vlorës, në Berat, në Lushnjë, në Shën Pjetër, në Bubullimë, Krutje, Fier, Mifol dhe Karavasta. Pjesëmarrja për çdo kamp ishte 40-60 fëmijë të moshës 7-14 vjeç.

Nga 27 gushti deri më 2 shtator në kishën e Profetit Ilia në qytetin e Korçës, u zhvillua kampi ditor

ku morën pjesë rreth 100 fëmijë. Në të fëmijët patën mundësinë të mësonin si të jetojnë besimin, të rriten brenda frymës së krishterë orthodhokse nëpërmjet bisedave shpirtërore të përditshme. Në fund u zhvillua edhe "festivali i fëmijëve", ku ata konkurruan me vjersha, këngë, skeçe dhe humor.

Kampet ditore u organizuan për herë të parë këtë vit edhe në qytetin e Librazhdit ku morën pjesë rreth 45 fëmijë. Në kamp u organizua një ndeshje e veçantë futbollit, si edhe një ekskursion në Manastirin e Shën Vlashit, në Durrës. Gjithashtu lojërat sportive i dhanë kampit një ditë tjetër të gëzueshme.

*Nga dhjak Niko Lushi,
dhjak Niko Petani,
Petro Halili,
Robert Pelushi,
Vangjel Qazimllari,
Entela Kostrita*

Kalendari i Liturgjive Hyjnore, NËNTOR 2007

1 E Enjte † Anargj. Kozma e Dami-an nga Azia. Dësh. i ri Jakovi etj.
3 E Shtunë † Dësh. Akepsimai, Josifi, Aithalai.

4 E Diel † 5 LLUKAIT. Osh. Joaniqi. Hierod. Nikandri i Mirës.
8 E Enjte † Kryeengjëjt Mihail e Gavriil dhe Fuqitë e Patrup.
9 E Premte † Nektari i Pentapojës. Dësh. Onisifori, Porfiri.
10 e Shtunë † Ap. Olimpai, Sospatri, Herodioni, Erasti nga të 70^t.

11 E Diel † 8 LLUKAIT. Dësh. Minai, Viktori, Vicenti, Stefanidha.
13 E Martë † Joan Gojarti i Kon/pojës. Oshd. i ri Damaskini.
14 E Mërkurë † # Ap. Filipi. Grigor Pallamai. Dësh. i ri Konstandini.
15 E Enjte Dësh. Guria, Samonai, Avivi. Pais Velickofski. (*Fillon Kreshma.*)

16 E Premte † * Ap. dhe Ungjillor Mateu. Dëshg. Ifigjenia.
17 E Shtunë † Grigori i Neoqesarisë. Genadi i Kon/pojës. Oshg. Hilda.

18 E diel † 9 LLUKAIT. Dësh. Platoni, Romani. Dësh. i ri Anastasi.
21 E Mërkurë † # Hyrja në tempull e Hyjlindëses Mari. Osh. Sozomeni.
24 E shtunë † Hierod. Klementi i Romës. Petro i Aleksandrisë.

25 E Diel † 13 LLUKAIT. *Mbyllja e Hyrjes.* Dëshg. Ekaterina.
30 E Premte † * Ap. Andrea, i parëthirruri. Frumenti i Etiopisë.



NGJALLJA

Organ i Kishës Orthodhokse
Autoqefale të Shqipërisë

**Themelues:
Kryepiskopi Anastas**

**Del nën kujdesin
e Këshillit Botues**

Kryeredaktor: Thoma Dhima

Adresa:

**Kryepiskopata Orthodhokse,
Rruga e Kavajës, Nr. 151
Tiranë**

Tel: (04) 234 117, 235 095.

Fax: 232 109

Shtypur

në shtypshkronjën "Ngjallja"

U krye Fronëzimi i Patriarkut të ri Orthodhoks të Rumanisë

Më 30 shtator, në Katedralen Patriarkale të Bukureshtit “Shën Konstandini dhe Shën Elena” u krye Fronëzimi i Patriarkut të ri të Rumanisë, Fortlurturisë së Tij Danielit. Ajo u krye me një Liturgji Hyjnore dhe Dhoksologjinë e rastit. Ishin të pranishëm Sino-

di i Shenjtë i Kishës Orthodhokse të Rumanisë, qindra besimtarë e klerikë, përfaqësues nga Kishat motra, nga kishat e tjera të krishtera dhe organizatat fetare ndërkombëtare, përfaqësuesit më të lartë të shtetit rumun etj. Në përfaqësi të Kishës Orthodhokse Auto-

qefale të Shqipërisë në Fronëzim mori pjesë Mitropolit i Korçës, Hirësia e Tij Joani.

Fronëzimi u pasua nga Sesioni festiv i Sinodit të Shenjtë në pallatin Patriarkal, ku u pritën urimet e rastit.

Fortlurturia e Tij Danieli, i cili njihet si teolog i shquar, me një vepër të gjerë dhe të vlerësuar, për të cilat ka marrë edhe shumë tituj akademikë dhe çmime, si themelues institucionesh teologjike, kulturore dhe bamirësie etj. Veçanërisht i vlerësuar brenda dhe jashtë vendit është edhe kontributi i tij në lëvizjen ekumenike dhe dialogun ndërjetar.



Patriarku i Ruisë flet para Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës

Duke folur përpara kësaj Asambleje në Strasburg, më 2 tetor, Patriarku Aleksej II, paralajmëroi për rrezikun e relativizimit moral dhe kërkoi një dialog urgjent midis këndvështrimeve fetare dhe shekullare. “Nëse do të injorojmë normat morale, ne injorojmë në fund të fundit edhe vetë lirinë”, - tha ai. “Nëse rregullat morale kapërcehen dhe deklarohen relative, do të minojmë themeli i vetë këndvështrimit evropian të botës. Vendet evropiane do rrezikojnë kështu të humbasin identitetin e tyre shpirtëror e kulturor dhe në fund edhe vendin e tyre në histori”, tha Patriarku, i cili

shtoi se “Për të evituar përplasje midis këndvështrimeve të ndryshme, ne kemi nevojë për një dialog serioz midis kulturave, në të cilin të përfaqësohen dhe të përfshihen të dyja traditat: fetare dhe shekullare”.

Ai gjithashtu paralajmëroi për rrezikun e progresit teknologjik në fusha si biotika dhe kartat elektronike të identitetit, që mund të sjellin kufizime të reja të të drejtave njerëzore.

Ky fjalim ishte pjesë e vizitës së Patriarkut Aleksej në Francë, gjatë së cilës u takua edhe me Presidentin Sarkozi, dhe me Konferencën Ispeshkvnore Romano-katolike etj.

Përse e duam Perëndinë?

Si është e mundur të mos dojë ndokush Perëndinë? Kë të duash, nëse nuk do Perëndinë? Dhe është shumë e drejtë kjo. Perëndia është i Miri suprem, i pakrijuar, pa fillim, pa fund dhe i paprishshëm.

“Askush nuk është i mirë, përveç një të vetmi, Perëndisë” (Mt.19:17).

Ashtu si dielli ndriçon gjithmonë, ashtu si zjarri ngroh gjithmonë, kështu edhe Perëndia që nga natyra e Tij është i mirë, gjithmonë bën të mirën. Duart e Tij të gjithfuqishme na krijuan. Na krijuan, jo ashtu si krijesat e tjera, pa ndjeshmëri, pa logjikë. Na krijuan me vullnetin e Tij hyjnor të veçantë.

“Pastaj Perëndia tha: ‘Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne dhe të ushtrojë sundimin e tij mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit, mbi kafshët e mbi gjithë tokën, mbi rrëshqanorët që zvarriten mbi dhe’” (Zan.1.26).

Për krijesat e tjera “Ai tha dhe u bënë, Ai urdhëroi dhe u krijuan” (Ps.148.5), por për njeriun nuk ndodhi e njëjta. Por çfarë? Ai tha: “Le ta bëjmë njeriun”. O vullnet i shenjtë, i mbushur me dashurinë e Perëndisë! Perëndia trihipostatike, Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë tha për njeriun: “Le ta bëjmë njeriun”. Por çfarë njeriu? “Sipas ikonës dhe ngjashmërisë” - tha Ai.

O mirësi e mrekullueshme e Perëndisë për njeriun! O nder i lartë njerëzor! Njeriu u krijua “sipas ikonës dhe ngjashmërisë”.

Cila krijesë u bë e denjë për një nder të tillë? Nuk njohim asnjë krijesë tjetër të ngjashme me të. Vetëm njeriu u nderua nga Perëndia të bëhet ikona e Tij e shenjtë.

Krijesa më e dashur dhe më e bukur e Perëndisë! Njeriu, i cili ka ikonën e Perëndisë mbi të si vulë mbretërore. Nderohet mbreti, nderohet dhe portreti i tij. Perëndia, mbreti i qiejve është i denjë për çdo nder. Po kështu edhe njeriu, ikona e Tij. Të tillë hir na dha Perëndia në krijimin tonë.

Si pra, të mos E duam?!

Ramë nga parajsa, dhe madje kaq ulët sa nuk mund të qajmë denjësisht për rënien tonë. Por Njeridashësi edhe në këtë gjendje

nuk na braktisi. Ai gjeti mënyrën e mrekullueshme të shpëtimit tonë. Dërgoi Birin e Tij të vetëmlindur të na takojë, të na shpëtojë dhe të na sjellë përsëri pranë Tij. “Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e Tij të Vetëmlindur, që kushdo që beson në Të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme” (Jn.3:16). **Pra, Perëndinë që na deshi kaq, si të mos E duam?!**

Perëndia është Njeridashës, ashtu si të gjithë E quajmë, por edhe njeriu duhet të jetë Perëndidashës. Dashuria nuk shpaguhet me asgjë tjetër, veçse me dashuri dhe mirënjohje. Perëndia është paramenduesi ynë. Paramendon dhe kujdeset për të gjithë. Na fal ushqimin, veshjet dhe shtëpinë ku banojmë. Të Tijat janë dielli, hëna dhe yjet që na ndriçojnë. Me zjarrin e Tij ngrohemi dhe përgatisim ushqimin tonë.

Me ujin e Tij lahemi dhe freskohemi, kafshët e Tij na shërbejnë, ajri i Tij na jep jetë, oksigjeni i Tij na mban në jetë. Me pak fjalë, varemi nga dashuria dhe të mirat e Tij. Pa këto, nuk mund të jetojmë asnjë moment.

Pra, si është e mundur të mos e duam një Bamirës të tillë?

Çdo njeri që na bën mirë, e duam. Sa më tepër duhet të duam Bamirësin Perëndi të Cilit i përkasin të gjitha, madje dhe vetja jonë dhe çdo gjë që kemi!

Gjithë krijimi dhe vetë njeriu janë pronë e Perëndisë. “Zotit i përket toka dhe të gjitha gjërat që janë mbi të, bota dhe banorët e saj” (Ps.24:1).

Perëndia është Ati ynë. Kur lutemi i themi: “Ati ynë që je në qiejt ..”.

Pra, si është e mundur, të mos e duam Atin tonë?!

Sa fëmijë besnikë duan pa dallim atin e tyre? Pra, nëse edhe ne duam të jemi fëmijë të vërtetë të Perëndisë dhe ta quajmë Atë, atëherë duhet dhe ta duam. Për rrjedhojë, në mënyrë të drejtë themi: **Si të mos e duash Perëndinë?**

Përktheu: Rozeta Baba

Shkëputur nga libri në greqisht “Udhëtim drejt qiellit”

Filloi me sukses viti i ri arsimor në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë

Mjedise dhe kushte mësimi bashkëkohore

Sipas traditës, nisja e vitit të ri shkollor 2007-2008, në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të Kishës sonë u shënuar ditën e parë me Shërbesën e Ajazmës, si bekim për mbarëvajtjen e tyre. Bashkë me përvojën e fituar vit pas viti dhe



nivelin cilësor të mësimdhënies, për të përgatitur në mënyrë dinjitoze brezat e ardhshëm, veçohen kushtet bashkëkohore të klasave dhe niveli i mjeteve mësimore që ndihmojnë në përmbushjen e qëllimit. Këto shkolla shërbejnë si laboratorë të ringjalljes shpirtërore dhe morale të shoqërisë sonë.

Në vitin e gjashtë të saj, **shkolla 9-vjeçare shqiptaro-amerikane "Protagonistët"**, në Tiranë, ndihet më e plotësuar me nxënës dhe staf. Sipas nëndrejtoreshës së saj, znj. Tatjana Dodbiba, këtë vit janë 11 klasa, me 172 nxënës dhe rreth 24 mësues, të gjithë të diplomuar sipas profileve.

Mjediset e shkollës janë shumë të mira dhe fëmijët ndihen të kënaqur në to. Mësuese Irena tha se ky fillim viti ishte shumë domethënës. "Kuptohemi shumë mirë bashkë, janë fëmijë të dëgjueshëm dhe të dashur me njëri-tjetrin. Me librat, fletoret e punës dhe mjetet didaktike jemi pajisur si nxënësit ashtu edhe ne mësuesit."

Edhe **shkolla 9-vjeçare shqiptaro-greke "Frymë Dashurie"**, në Durrës, hapi dyert



në vitin e tretë të saj dhe ka rreth 50 nxënës. Mësuese Elsa na tha se: "Viti i ri shkollor ka nisur mbarë. Në ditën e parë të shkollës, pas një programi festiv filloi mësimi. Klasat ishin të pajisura dhe të rregulluara mjaft mirë, ndërsa nxënësit të pajisur me të gjithë librat. Që në ditën e parë të mësimi mësuesit dhe nxënësit filluan realizimin e programit mësimor Nxënësve iu dha orari i mësimëve, i cili zbatohet me korrektësi".

Atmosfera e fillimit të shkollës u përjetua me gëzim edhe nga **fëmijët e "Shtëpisë Orthodhokse të Shpresës"**. Nga 30 që ajo mirëpret, 11 prej tyre ndjekin mësimet në shkollën "Frymë Dashurie", duke pasur edhe ndihmën në edukim të personelit të Shtëpisë, prej 17 punonjësish. Kisha jonë me kujdesin e veçantë të Kryepiskopit Anastas ka mundësuar mbulimin e të gjitha shpenzimeve, përfshirë edhe ato shkollore.

Edhe në Mitropolinë e Gjirokastrës nisi viti i ri arsimor me shumë bekime nga Perëndia.



Në **Liceun Kishtar "Kryqi i Nderuar"** u krye Shërbesa e Ajazmës nga Mitropoliti Dhimitër. Në ceremoni merrnin pjesë prefekti i Gjirokastrës, z. Spiro Ksera, drejtori i përgjithshëm i arsimit të rrethit, z. Vasil Muka, kryetari i Omonias, z. Jani Jani dhe personalitete të spikatura të kulturës dhe arsimit në qytet. Bekimi i fillimit të vitit të ri arsimor u zhvillua në oborrin e shkollës, ku 62 nxënësit, bashkë me mësuesit e tyre dhe të ftuar të tjerë nga zona të ndryshme të Mitropolisë morën bekimin për nisjen e një viti të mbarë shkollor.

Në fjalën përshëndetëse, Mitropoliti Dhimitër tha se: "Të gjitha këto vepra nuk bëhen pa mundim dhe sakrificë dhe i pari i mban Kryepiskopi Anastas. Interesimi që ai tregon mbulon të gjitha nevojat tona materiale. Besimi i tij është se ju përbëni ecjen përpara të Kishës sonë në shoqërinë njerëzore në çdo pikë të

globit. Të jeni të parët në mësim, në moral dhe në ndjenjën e përpjekjes. Sjellja juaj të jetë në një vijë me emrin që mban shkolla jonë. Kur



jemi të lirë në mendim, atëherë gëzojmë liri të madhe në jetë"- iu tha Hirësia e Tij nxënësve.

Në vitin e dytë të saj çeli dyert edhe **shkolla e mesme profesionale në Mesopotam të Sarandës**, ku studiojnë 104 nxënës në degët: informatikë, instalime hidraulike, instalime elektrike dhe instalime frigoriferike. Në bisedën që patëm me drejtorin e kësaj shkolle z. Orfea Beci, mësuam se këtë vit ka pasur shumë kërkesa dhe numri i pranimeve të nxënësve ka qenë i kufizuar. Arsimi kishtar dhe profesional në Mitropolinë e Gjirokastrës po njih nga viti në vit një përparim të dukshëm duke shërbyer si një fidanishte e të ardhmes së Kishës dhe të shoqërisë shqiptare.

Për herë të parë këtë vit u **hap në Sukth të Durrësit edhe liceu kishtar "Kryqi i Nderuar"**, me 22 nxënës në vitin e parë dhe 15 në vitin e dytë. Stafu administrativ e pedagogjik i kësaj shkolle është mjaft i përgatitur për të kryer detyrën në formimin shkencor dhe shpirtëror të të rinjve. Përveç mjediseve të tjera, shkolla ka edhe një konvikt ku kushtet ashtu si gjithë ambientet e saj janë nga më modernet.

Organizimi shumë i mirë për fillimin e mbarë të vitit të ri shkollor në shkollat e sistemit 9-vjeçar dhe të mesëm të themeluara dhe të mbështetura nga Kisha jonë, me bekimin dhe mundësitë e krijuara nga Fortlumturia e Tij, Kryepiskopi Anastas, tregon vlerësimin e madh që i jepet formimit të një brezi të ri me dije e kulturë, por edhe të formuar shpirtërisht për të ardhmen e vendit.

Përgatitën:

*Isidor Koti, Julia Pjetri,
Gabriela Dalipi*